

e braktisë fshatin dhe u fshehën në pyllin e quajtur *Prroi i Thatë/Presahli potok*, që ishte përmbi fshatin e tyre. Por, Brahimi ndenji në shtëpinë e vet në **Nekoc/Nekovce** [*Mëhalla Kastrati*]. Pas pesë ditësh, më 28.08.1998, vëllai i Brahimit, Ramadani, dhe disa pjesëtarë të tjerë të UÇK-së u kthyen në fshat. Trupin e pajetë të Brahimit e kanë gjetur përpara dyqanit të Azem Bajres, jo shumë larg nga shtëpia familjare. Në gjoks i kishte tri plagë nga plumbat. Po atë ditë, e varrosën në një pyll përmbi fshatin e Divlakës/Divljaka. Pas përfundimit të luftës, më 8.04.2000, familjarët i kanë varrosur mbetjet mortore të Brahimit në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Nekoc/Nekovce.

**Burimi:** deklarata R.K, FDH-18040.

### **Nebih (Tafil) Qelaj**

(29.2.1953, shqiptar nga Nekoci/Nekovce, komuna e Gllgocit/Glogovac, teknik e veterinarisë, katër fëmijë)

Nebihu ka mbetur në shtëpi, përderisa familjarët e tij, së bashku me fshatarë të tjerë, i braktisë shtëpitë e veta më **23.08.1998**. Nga fshati **Nekoc/Nekovce**, ata shkuan në pyllin e quajtur *Prroi i Thatë/Presahli Potok*. Pas pesë ditësh, pjesëtarë të UÇK-së dhe fshatarë e kanë gjetur trupin e pajetë të Nebihut në shtëpinë e tij. Trupi i tij ka qenë i karbonizuar. Po atë ditë, e varrosën në pyllin përmbi fshatin e Divlakës/Divljaka. Pas përfundimit të luftës, në datën 6.04.2000, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Nebiut në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Nekoc/Nekovce.

**Burimi:** deklarata S.Q, FDH-18041.

### **Fatmir (Nuredin) Nika**

(15.02.1975, shqiptar nga Gllanasella/Gladno Selo, komuna e Gllgocit/Glogovac, jurist, pjesëtar i UÇK-së)

Edhe pse kishte diplomuar në Fakultetin Juridik, Fatmiri punonte si arsimtar i gjuhës frënge në shkollën fillore në Dobroshec/Dobroševac. Ka luajtur role të ndryshme në teatrin e Gllgocit/Glogovac. Pas vrasjes së anëtarëve të familjes Jashari [të shikohen

regjistrimet], ai aderoi në UÇK. Kishte për detyrë t'i mbante pozicionet e UÇK-së përreth fshatit të **Gllanasellës/Gladno Selo**. Në mbrëmjen e datës **25.08.1998**, ai shkoi në rojë pranë stacionit trafo për shpërndarjen e rrymës elektrike. Në të njëjtën mbrëmje, forcat serbe e kanë kryer një sulm kundër stacionit trafo dhe, me këtë rast, Fatmiri ka rënë në betejë. U varros në varrezat lokale një ditë më vonë. Atje, ai prehet edhe sot.

**Burimet:** deklarata L.N, FDH-30775; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

### **Haki (Zenë) Deliu**

(16.03.1959, shqiptar nga Rrezalla/Rezale, komuna e Skënderajt/Srbica, tregtar, pesë fëmijë)

Hakui punonte në shitoren e vet në fshatin e lindjes në Rrezallë/Rezale. Ajo gjendej para shtëpisë, në të cilën ai jetonte me familjen e vet. Në datën **26.08.1998**, Hakiu, së bashku me dhëndrin Zymerin dhe kushëririn Safetin, u nis me makinë për në Prishtinë për tu furnizuar me mallra. Për shkak të pranisë së shtuar të forcave serbe në rajon, ata udhëtonin përmes rrugëve dytësore. Kur iu afruan vendit të quajtur *Kroi i Mbretit/Careva çesma*, në fshatin **Korroticë e Epërme/Gornja Koretica**, ata u vunë re nga forcat serbe, të cilat pa paralajmërim dhe menjëherë kanë shtënë ndaj udhëtarëve. Një plumb e ka qëlluar Hakium në gjoks duke ia marr jetën në vend. Safetin vetëm e plagosën. Ai dhe Zymeri ia arritën që të arratiseshin me vrap nga vendi i ngjarjes, përderisa trupi i pajetë i Hakiut ka mbetur në makinë. Në orët e vona të mbrëmjes, Safeti, Zymeri dhe disa pjesëtarë të UÇK-së shkuan në vendin e vrasjes, e morën trupin e Hakiut dhe e bartën në spitalin e UÇK-së në fshatit Gradicë/Gradica. Një ditë më vonë, Hakium e varrosën në Rezallë/Rezale.

**Burimet:** deklarata V.D, FDH-14416; deklarata V.D, FDH-2747; deklarata M.D, FDH-2748.

### **Besnik (Mehmet) Krasniqi**

(22.08.1972, shqiptar nga Negroci/Negrovce, komuna e Gllgocit/Glogovac, punëtor ndërtimor, pjesëtar i UÇK-s)